



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIM

Nr. 145 Datë 26.10.2012

PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E
PËRDITËSIMIT TË APLIKIMIT TË TARIFAVE PËR VITET 2012-
2014 TË OST SH.A PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE
2012-2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr. 59, datë 29.12.2005, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a për periudhën e tretë rregullatore.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI